



C.nr.361/17

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ-** Departamenti i Pergjithshem- Divizioni Civil, me gjyqtarin Bekim Salihu dhe bashkëpunëtoren profesioanle [REDACTED], në çështjen juridike të paditësit Comfort Sh.p.k me përfaqësuesin e autorizuar [REDACTED], kundër të paditurit [REDACTED] nga fsh. [REDACTED], Komuna e Ferizajt, në çështjen juridike kompenzim dëmi, në seancën e mbajtur me datë 05.10.2018, merr këtë:

**A K T G J Y K I M**

*-për shkak të mungesës-*

**APROVOHET** kërkesëpadia e paditëses Comfort Sh.p.k me përfaqësuesin e autorizuar [REDACTED] si e bazuar.

**DETYROHET** i padituri [REDACTED] nga fsh. [REDACTED], Komuna e Ferizajt, që paditësit të i'a paguajë shumën prej 17,912.93€, me kamatë ligjore sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar, e cila do të llogaritet nga dita e paraqitjes padisë deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 274€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë.

**DETYROHET** paditësja që të paguaj shumën prej 80 euro në emër të taksës gjyqësore .

**A r s y e t i m i**

Paditësi ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datë 27.04.2017, kundër të paditurit [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] Komuna e Ferizajt, në çështjen juridike kompenzim dëmi, të cilës i ka bashkangjitur provat përkatëse lidhur me pretendimet faktike të paraqitura në padi.

Gjykata për këtë çështje ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor me datën 05.10.2018, ku për këtë seancë palët kanë qenë të ftuar në mënyrë të rregullt, por i padituri edhe pse ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi dhe ftesën në mënyrë të rregullt mungesën nuk e ka arsyetuar, si dhe nuk ka kërkuar shtyerje të seancës. Sipas propozimit të paditësit, gjykata ka aprovuar mbajtjen e seancës në mungesë të paditurit.

Paditësi në seancë dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar: mbetem në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe i propozojë gjykatës që ta obligojë të paditurin ta kompenzoj shumën prej 5000 euro për tjetërsimin e automjetit të paditësit, ku i padituri e kishte marrë me qira automjetin tek paditësja dhe nuk e ka kthyer me duke e tjetërsuar tek personat e tretë, si dhe shumën prej 12,912.93€ për kompenzimin e fitimit të humbur për periudhën kohore nga data 05.04.2016 deri në muajin shtatore të vitit 2018, sipas ekspertizës së ekspertit financiarë, gjithashtu i kërkoj edhe shpenzimet e procedurës dhe atë për takse gjyqësore shumën prej 20 euro, për përpilimin e padisë shumën prej 104 euro si dhe shpenzimet për ekspert shumën prej

150 euro, duke e llogaritur kamaten ligjore siq e aplikojnë bankat në Republikën e Kosovës për mjetet e deponuara pa destinim të caktuar mbi një vit nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesen definitive .

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtës të gjendjes faktike të çështjes, për aq sa palët ndërgjyqëse i parashtruan ato në këtë procedurë, bazuar në nenin 7.1 të LPK-së, ka bërë administrimin e provave si vijojnë: certifikata e biznesit me nr 71252973 e lëshuar me datë 04.05.2016, kontrata mbi shitblerjen e automjetit e vërtetuar pranë noterit [REDAKTUAR] me shenjën LRP.nr.996/16 e datës 31.03.2016, kontrata mbi qiramarrjen e SHPK Comfort e lidhur me datë 05.04.2016 deri 08.04.2016, autorizimi noterial LRP.nr.2533/2017 i datës 02.03.2017, ekspertiza financiare e datës 21.09.2018, autorizimi noterial LRP.nr.126016/2018 i datës 17.09.2018.

Gjykata vendim mbi pagesën e automjetit të tjetërsuar e bazoi në kontratën e shitblerjes së automjetit me numwr LRP.nr.996/2016 e datës 31.03.2016 ku e paditura e kishte blerë veturën VW 1 K (Golf 2.0 TDI), në shumë prej 5000 euro. Ndërsa vendim për pagesën e kompensimit të humbur gjykata ia fali besimin ekspertizës së ekspertit financiarë të datës 21.09.2018.

Bazuar në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe vlerësimit të tyre, në kuptim të nenit 8 par 1 dhe 2 të LPK-së, gjykata ka vërtetuar se kërkesë padia është e bazuar.

Gjykata ka aprovuar propozimin e paditësit, për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mungesës, meqenëse në rastin konkret janë përmbushur konditat ligjore nga neni 151 par.1 pika a) deri e) të LPK-së, respektivisht se i padituri edhe pse ka qenë i ftuar me rregullë nuk ka marrë pjesë në këtë seancë si dhe mungesën e tij nuk e ka arsyetuar për këtë seancë, se nga gjendja e fakteve dhe provave të çështjes, rezulton si e themeltë kërkesëpadia e paditësit dhe se kjo gjendje e fakteve nuk është kontestuar edhe pse i njejt ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, gjithashtu gjendja e fakteve është në harmoni me provat e prezentuara nga paditësi në padinë e tij dhe se nuk ekzistojnë rrethana që janë të njohura botërisht për pengesat eventuale që i padituri të mos paraqiten në seancën e shqyrtimit kryesor të çështjes me datën 05.10.2018.

Gjykata lidhur me kamatën ka vendosur në bazë të nenit 378 të LMD-së.

Andaj nga të theksuarat më lartë, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

REPUBLIKA E KOSOVËS



REPUBLIKA KOSOVO

C.nr.361/17, me datën 05.10.2018

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ II UROŠEVAC

Më  
Dana

13. 12 20 18



Gjyqtari,

Bekim Salihu

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.